

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshem - me Gjyqtaren Diana Sina, si dhe me procesmbajtësen Lamije Kuqi, duke vendosur në lëndën penale kundër të akuzuarit S. (E.) S.nga fshati D. K.Rahovec, sipas Aktakuzës të PTH-DP në Gjakovë, PP.nr.1583/2018 të datës 12.11.2018, për shkak të veprës penale, **blerja,pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale nga neni 345 par.2 të KPRK-së** duke vendosur në lidhje me propozimin për dhënien e urdhërit ndëshkimor me datën **21.12.2018**, mori këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e PTH-DP në Gjakovë, PP.nr.1583/2018 e datës 12.11.2018 dhe kjo Gjykatë, jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

I A K U Z U A R I:

S. S.nga i ati E. dhe e ëma K., e gjinisë P., data e lindjes . . . , në fshatin D. K.Rahovec, ku edhe tani banon, ka të kryer shkollën e mesme, i pa martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, me profesion frizer,shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,më parë i pa dënuar.

Ë s h t ë f a j t o r :

Sepse: Me datë të pa caktuar të muajit Qershor 2018,në Gjakovë,saktësisht tek lojërat që ishin të vendosura prapa ,ka blerë sendin për të cilin ka mundur të dijë se është përfituar me kryerjen e veprës penale,në atë mënyrë që nga një person me emrin V. G.nga Shqipëria,ka blerë telefonin e tipit “. .. ”me ngjyrë të zezë pronë e të dëmtuarës H. D.,ashtu që për çmimin e ofruar prej 150 euro ka dhënë telefonin e tij”. . .”si dhe para të gatshme në shumën prej 70 euro,e që kjo është vërtetuar në bazë të përgjigjes në urdhëresën për masa të fshehta të kompanisë së telefonisë mobile “**Vala**”,ku është konstatuar se telefoni në fjalë gjendej në posedim të të akuzuarit S. S.

- **Me çka kryer veprën penale blerja,pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale nga neni 345 par.2 të KPRK-së**

Andaj, Gjykata konform nenit 493 të KPRK-së, të akuzuarit,

I S H Q I P T O N

Dënim me gjobë në shumën prej **250.-(Dyqindpesëdhjetë).-€**, të cilën dënim duhet ta paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së Aktgjykimit.

Nëse personi i dënuar nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj gjobën, Gjykata në bazë të nenit 46 par.3 të KPPK-së, dënimi me gjobë do ta zëvendësojë me dënim burgu në kohëzgjatje prej **12(Dymbëdhjetë) ditësh**, duke llogaritur çdo ditë të qëndrimit në burgim nga **20.-€.(njëzet) euro**, të gjobës.

Detyrohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve procedurale, në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej **30,00 €**, e **krejt këto** në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

E dëmtuara H. (M.) D. nga Gjakova, me banim në adresën Rr". . . " në Gjakovë, kompensimin e dëmit mund ta realizojë në kontest civil.

A r s y e t i m

Pranë kësaj Gjykate Prokuroria Themelore-Departamenti i Përgjithshëm në Gjakovë, ka ngritur Aktakuzë PP.nr.1583/2018 të datës 12.11.2018, kundër të akuzuarit S. S. nga fshati D. K. Rahovec, për shkak të veprës penale, **blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale nga neni 345 par.2 të KPRK-së**, me propozim që ndaj të akuzuarit ti jepet urdhër ndëshkimor dhe të njëjtit ti shqiptohet dënimi me gjobë pa mbajtur shqyrtimin gjyqësor.

Gjykata me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes komfor nenit 495 të KPPK-së gjeti se janë plotësuar kushtet nga dispozita e nenit 493 të KPPK-së dhe pa mbajtur shqyrtimin gjyqësor, vendosi që të pranojë kërkesën e PTH-DP në Gjakovë, për dhënien e urdhrit ndëshkimor dhe ti shqiptojë ndaj të akuzuarit dënim me gjobë si në dispozitiv të Aktgjykimit.

Para se të vazhdohet me arsyetim të Aktgjykimit për palën e pa udhëzuar është e nevojshme që ti referohet dispozitës së nenit 345 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së e cila dispozitë për kryesin e kësaj vepre penale parasheh dënim me burgim deri në një (1) vit.

Gjykata vlerëson se provat që janë bashkangjitur propozimit për dhënien e urdhërit ndëshkimor të cilat gjenden në shkresat e lëndës siç janë:

- Deklarata e të akuzuarit S. S. e dhënë në Stacionin Policor në Gjakovë me dt.23.10.2018, dhe në Prokurorinë Themelore në Gjakovë me dt.02.11.2018.
- Deklarata e të dëmtuarës H. D. e dhënë në Stacionin Policor në Gjakovë me dt.31.05.2018,
- Raporti i oficerit P.Sh. të Stacionit Policor në Gjakovë me nr të ID #... dt.01.06.2018,
- Urdhëresa për Masa të Fshehta e lëshuar nga ana e Prokurorisë Themelore në Gjakovë nën shenjë RLN/II.nr.109/2018 dt .05.09.2018,
- Informacioni lëshuar nga Telekom i Kosovës – Zyra për Realizimin e Kërkesave Ligjore dt.21.09.2018,
- Kallëzimi penal me nr.2018-EA-500 dt.31.05.2018 i parashtruar nga Stacioni Policor në Gjakovë – Njësia e Hetimeve, si dhe shkresat tjera përbërëse të lëndës janë provat të mjaftueshme me të cilën argumentohet se i akuzuari është kryes i veprës penale për të cilën pandehet.

Gjykata, këtë dënim e ka shqiptuar me bindje se me të njëjtin do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41 të KPRK-së, në mënyrë që të parandalojë kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, si dhe të përmbajë personat tjerë nga kryerja e veprave penale.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor, është marrë konform nenit 450 par.1 dhe 2 nën paragraf 2.1 dhe 2.6 të KPPK-së.

Vendimi për udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest civil, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, është marrë bazuar në nenin 463 par.2 të KPPK-së.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi mbi urdhërin ndëshkimor.

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË,
P.nr.802/2018, më datën 21.12.2018.**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi i akuzuari dhe mbrojtësi i tij mund të ushtrojnë Kundërshtim, në afat prej **8** ditësh nga dita e marrjes së të njëjtës, Gjyqtarit të kësaj Gjykate. Nëse i pandehuri nuk ushtron kundërshtim, Aktgjykimi do të marrë formë të prerë.